



# Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror 2021

Gusht, 2021

E drejta e autorit © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +383 (0) 38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

**Autore:** Agnesa Haxhiu

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Përmbledhje.....</b>	<b>4</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>7</b>
<b>Përmbushja e agjendës legislative.....</b>	<b>8</b>
<b>Procesi Mbikëqyrës.....</b>	<b>12</b>
Pyetjet parlamentare .....	12
Interpelancat dhe debatet parlamentare .....	14
Rezolutat .....	15
Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve .....	16
Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura.....	17
Raportimet e ministrave në komisionet parlamentare.....	19
<b>Performanca e trupave të punës së Kuvendit.....</b>	<b>20</b>
Kryesia e Kuvendit .....	20
Komisionet parlamentare .....	21
<b>Mbarëvajtja e seancave parlamentare .....</b>	<b>22</b>
Pjesëmarrja e deputetëve në seanca .....	24
<b>Rekomandimet .....</b>	<b>26</b>

## Përmbledhje

Me publikimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese më 21 dhjetor 2020, zgjedhja e ish-qeverisë Hoti u konsiderua në kundërshtim me Kushtetutën, duke përcaktuar se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Pas zgjedhjeve të parakohshme të 14 shkurtit 2021, më 22 mars 2021 u konstituua legjislatura e VIII-të e Kuvendit të Kosovës. Në të njëjtën ditë, Kuvendi zgjodhi me shumicë votash qeverinë e re të kryesuar nga kryeministri Albin Kurti, bazuar në një koalicion parazgjedhor midis Lëvizja Vetëvendosje dhe Listës Vjosa.

Sesioni parlamentar mars – gusht 2021 gjegjësisht sesioni i parë i punës së legjislaturës së VIII-të u karakterizua me një ritëm të ngadaltë të punës në procesin legjislativ por me performancë më të mirë në rolin mbikëqyrës. Referuar vendimmarrjes legjislative, ky sesion parlamentar shënoi një numër të ulët të ligjeve (7) në raport me 10 ligje të miratuara në të njëjtën periudhë të legjislaturës së VII-të. Mbështetur në agjendën legjislative të Kuvendit, deri në përfundim të sesionit pranveror të punës janë proceduar 29 projektligje, prej të cilave vetëm shtatë janë miratuar ndërsa 22 të tjerë janë në procedurë të shqyrtimit. Dy nga tërësia e projektligjeve të proceduara janë nisma ligjore të deputetëve. Në anën tjetër, Qeveria për këtë periudhë kohore ka proceduar në Kuvend vetëm 27 nga 65 projektligje sa kanë qenë të parapara për procedim për periudhën prill -gusht dhe vonesat e tilla kanë ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën e punës së Kuvendit në shqyrtimin e tyre.

Ndonëse në legjislaturën e kaluar ishte sfidë arritja e kuorumit edhe për ligjet bazike që kërkojnë shumicë të thjeshtë të votave, gjithsesi pavarësisht që kjo legjislaturë ka një shumicë të konsoliduar mungesa e kuorumit ka vazhduar të jetë prezente. Pa pjesëmarrjen e opozitës në votim, sfida kryesore e Kuvendit, në muajt e fundit të këtij sesioni, u bë arritja e kuorumit në vendimmarrje në pikat që kërkonin 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, siç ishte rasti me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në mungesë të votave të mjaftueshme, dy marrëveshje ndërkombëtare u ratifikuan vetëm pas tentativës së tretë pasi ishin prezantuar para deputetëve në seancë. Ndërsa dy marrëveshje të tjera kanë mbetur në procedurë për votim në seancë pasi që për to nuk ka është arritur konsensusi



Nëse analizojmë punën e Kuvendit të Kosovës në këtë sesion të parë parlamentar të legjislaturës së VIII-të, shohim se ka shënuar rritje të lehtë të numrit të përgjithshëm të seancave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjegjësisht sesionin pranveror të legjislaturës së VII-të. Prej fillimit të kësaj legjislature janë mbajtur 23 seanca (duke përfshirë edhe seancën konstituive) prej të cilave 15 ishin të rregullta, katër të jashtëzakonshme dhe dy solemne. Në 13 raste seancat kanë vazhduar për një ditë tjetër ndërkaq tri prej tyre nuk kanë arritur të përmbyllen për shkak të mungesës së kuorumit për t'iu dhënë epilog katër pikave të mbetura nga këto seanca.

Një problematikë që e ka përcjellë këtë periudhë të punës së Kuvendit ngjashëm si në të kaluarën janë mungesat e shumta të deputetëve në seancë, veprime këto që padyshim që kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punimeve plenare. Sipas të dhënave të siguruar nga Kuvendi, deri në fund të muajit korrik deputetët kanë munguar plot 414 herë. Nëse kalkullohet mesatarja e mungesave të deputetëve për secilën seancë, i bie që mesatarisht kanë munguar deri në 15 deputetë.

Një tjetër aspekt që e karakterizoi sesioni pranveror ishte shkarkimi i plotë të bordeve të institucioneve të pavarura dhe shkarkime individuale. Në këtë drejtim, mes shumicës parlamentare dhe opozitës ka pasur mospajtime të thella për rekomandimet e komisioneve përkatëse për shkarkim në përgjithësi dhe procedurën e shkarkimeve në veçanti. Pavarësisht mospajtimeve, Kuvendi me shumicë votash ka shkarkuar bordet e katër institucioneve të pavarura siç janë: bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), bordin e Radio Televizionit të Kosovës (RTK), bordin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), bordin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) si dhe një anëtar të bordit të KOSTT-it. Gjatë këtij sesioni parlamentar, Kuvendi ka zgjedhur gjithsej 39 anëtarë të bordeve dhe pesë kryesues të institucioneve të pavarura, ndërsa kanë dështuar të zgjedhin pesë zëvendësit e Avokatit të popullit, një gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe tre anëtarë të KPM-së.

Të dhënat e monitorimit për periudhën raportuese, tregojnë se gjatë këtij sesioni për dallim nga

periudha e njëjtë e legjislaturës së VII-të, Kuvendi ka shënuar një ngritje të performancës në ushtrimin e rolit mbikëqyrës me fokus kryesor në mekanizmin e pyetjeve parlamentare. Mekanizmin e pyetjeve parlamentare si formë e ushtrimit të rolit mbikëqyrës e kanë shfrytëzuar 39 deputetë nga 120 sa janë gjithsej. Për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar, kur ishin parashtruar gjithsej 71 pyetje parlamentare, këtë sesion Kuvendi i Kosovës është shquar për numër më të madh të pyetjeve parlamentare gjegjësisht 108 pyetje parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar, apo 37 pyetje më shumë. Për periudhën raportuese, Kuvendi ka mbajtur vetëm dy interpelanca dhe pesë debate parlamentare. Ndërkaq janë propozuar shtatë projekt-rezoluta, prej të cilave vetëm një ka marrë përkrahjen e Kuvendit, gjashtë të tjera janë hedhur poshtë.

Sa i përket mbikëqyrjes nga komisionet parlamentare, 10 prej 14 komisioneve parlamentare kanë ftuar për raportim anëtarët e kabinetit qeveritar. Për periudhën raportuese, gjithsej 31 herë kanë raportuar ministrat në komisionet përkatëse, që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë tetë raportime më shumë.

Mbështetur në planet vjetore të komisioneve përkatëse, për sesionin pranveror të këtij viti ishin planifikuar të mbikëqyren gjithsej 11 ligje. Gjatë kësaj periudhe kohore, Kuvendi ka miratuar vetëm një raport për mbikëqyrjen e ligjit, atë për Shoqëritë Tregtare, të përpiluar nga Komisioni për Ekonomi.

Në bazë të monitorimit që KDI i ka bërë komisioneve parlamentare, gjatë sesionit pranveror 2021, komisionet parlamentare kanë realizuar gjithsej 176 mbledhje, si dhe janë zhvilluar gjashtë dëgjime publike. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, kur janë mbajtur 145 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publike, shohim se gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 31 mbledhje dhe pesë dëgjime publike më shumë.

Gjatë kësaj periudhe, Kryesia e Kuvendit ka mbajtur gjithsej 18 mbledhje që, për dallim nga periudhën e njëjtë e vitit 2020, është mbledhur dy herë më shumë. Takimet e rregullta të kësaj trupe kanë kontribuar në organizim dhe menaxhim më të mirë të punëve në Kuvend dhe mbarëvajtjen e punimeve plenare.

## Hyrje

Kjo analizë paraqet vlerësimin e punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror të këtij viti, gjegjësisht sesionin e parë të punës së legjislaturës së VIII-të. Gjatë periudhës vlerësuese, KDI ka monitoruar në mënyrë aktive mbarëvajtjen e punimeve të të gjithë trupave të Kuvendit. Kjo analizë përmban të dhëna statistikore të mbledhura nga monitoruesit e KDI-së, të cilat janë analizuar dhe prezantuar në mënyrë të detajuar.

Në pjesën e parë analiza fokusohet në vlerësimin e procesit ligjbërës dhe përputhshmërinë me Rregulloren e punës duke i përfshirë statistikatat për agjendën legjislative dhe mbarëvajtjen e shqyrtimit të projektligjeve në komisionet parlamentare dhe në seanca. Në pjesën e dytë, analiza trajton punën e Kuvendit në aspekt të mbikëqyrjes parlamentare duke përfshirë këtu të gjitha aktivitetet mbikëqyrëse që i kanë realizuar deputetet këtë sesion. Ndërkaq në pjesën e tretë, kjo analizë paraqet në mënyrë statistikore punën e të gjithë trupave të Kuvendit dhe mbarëvajtjen e punimeve në përgjithësi, vendimmarrjen mazhorancë - opozitë dhe pjesëmarrjen e deputetëve në punimet e Kuvendit, qoftë në seanca apo komisione parlamentare.

## **Përmbushja e agjendës legjislative**

Ashtu siç është ndërtuar praktika viteve të fundit, Kuvendi edhe këtë vit ka punuar pa një program vjetor të punës ashtu siç e parasheh Rregullorja. Ndonëse është hartuar një draft i plan-programit të punës për këtë vit dhe është trajtuar nga Kryesia e Kuvendit, i njëjti nuk është përcjellë në seancë për diskutim dhe aprovim, konform procedurave parlamentare.

Programi legjislativ i Qeverisë është miratuar më 7 maj 2021, përkatësisht 46 ditë pas marrjes së mandatit nga Qeveria Kurti dhe me ndryshimet që ka pësuar në ndërkohë, numri i projektligjeve të sponsorizuara për këtë vit është 193 (për dy sesionet e punës për vitin 2021). Qeveria ka paraparë që të procedohen në Kuvend gjithsej 65 projektligje gjatë sesionit pranveror të punës së Kuvendit, gjegjësisht deri në muajin gusht të këtij viti. Përkundër këtyre planifikimeve, Qeveria për këtë periudhë kohore ka proceduar në Kuvend vetëm 27 projektligje nga 65 sa kanë qenë të parapara për procedim.

Përfundim dy projektligjeve të sponsorizuara nga Qeveria që janë proceduar në Kuvend qysh në fillim të mandatit, pa u miratuar ende programi i tyre legjislativ, projektligjet e tjera kanë filluar të procedohen në Kuvend një muaj pas miratimit të programit legjislativ. Këto vonesa kanë ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën e punës së Kuvendit në shqyrtimin e tyre duke marrë parasysh faktin që procedurat e rregullta për shqyrtim të projektligjeve marrin rreth tre muaj deri në miratimin final.

Sa i takon agjendës legjislative të Kuvendit, deri në përfundim të sesionit pranveror të punës janë proceduar 29 projektligje, dy prej tyre nisma ligjore, prej të cilave vetëm shtatë janë miratuar ndërsa 22 të tjera janë në procedurë të shqyrtimit në komisionet parlamentare. Në krahasim me periudhën e njëjtë të legjislaturës së VII-të, ku ishin miratuar 10 ligje, në periudhën raportuese janë miratuar tri ligje më pak.






Fig.1 Përmbushja e agjendës legislative gjatë sesionit pranveror 2021

Tri nga ligjet e miratuara janë plotësim-ndryshim i ligjeve ekzistuese<sup>1</sup> ndërsa në mesin e ligjeve të miratuara nuk ka asnjë ligj të ri. Nga tërësia e ligjeve të miratuara, katër janë ligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Ligji për plotësim – ndryshimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021; Ligji për plotësim – ndryshimin e Ligjit për Automjete; Ligji për plotësim – ndryshimin e Kodit të procedurës penale.

<sup>2</sup> Ligji për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Ligji për amendamentimin 02 të marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe Të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim “KSV/017 Programi për mbështetje shëndetësore (Pjesa II); Ligji për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të marrëveshjes kornizë së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për financimin e projektit “Reagimi emergjent ndaj COVID -19”; Ligji për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të marrëveshjes të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze në lidhje me programin kornizë për bashkëpunim financiar.




Fig.2 Llojet e ligjeve të miratuara nga Kuvendi gjatë sesionit pranveror 2021

Për këtë sesion parlamentar, në Kuvend janë proceduar dy nisma ligjore nga dy grupe parlamentare, ai i LVV-së dhe PDK-së. Nisma ligjore për plotësim – ndryshimin e Ligjit për Automjete e iniciuar nga GP i LVV-së, për të cilin ka dhënë mendim edhe Qeveria, është shqyrtuar dhe miratuar brenda këtij sesioni të punës. Ndërkaq nisma ligjore për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar e iniciuar nga GP i PDK-së, ndonëse nuk ka marrë mendim nga Qeveria brenda afatit për një muaj siç parasheh Rregullorja e Punës së Kuvendit, ka hyrë në procedurë për shqyrtim në Kuvend. Mirëpo, deri në përfundim të këtij sesioni parlamentar kjo nismë nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës.

Edhe në këtë periudhë raportuese, Kuvendi ka vazhduar me praktikën e shqyrtimit të projektligjeve në procedurë të përshpejtuar, ku vetëm gjatë këtyre muajve, dy nga ligjet e miratuara janë shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar: ai për plotësim ndryshimin e Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit 2021 dhe Ligji për plotësim–ndryshimin e Kodit të procedurës penale, duke iu shmangur afateve procedurale të parapara me nenin 565, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Edhe në sesion e parë të punës së kësaj legjislature, mungesa e kuorumit në votim ka qenë sfidë në procesin ligjvënës. Kjo problematikë është shpërfaqur kryesisht gjatë miratimit të pikave që kërkojnë



konsensus më të gjerë politik, siç janë ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është përcjellë me mospajtime të mëdha ndërmjet deputetëve të mazhorancës dhe opozitës. Në mungesë të votave të 2/3 së deputetëve, dy marrëveshje ndërkombëtare u ratifikuan vetëm pas tentativës së tretë pasi ishin prezantuar para deputetëve në seancë. Ndërsa dy marrëveshje të tjera kanë mbetur në procedurë për votim në seancë pasi që për to nuk ka është arritur konsensusi i nevojshëm mes grupeve parlamentare

## **Procesi Mbikëqyrës**

Funksioni i mbikëqyrjes parlamentare i mundëson Kuvendit që të mbaj qeverinë llogaridhënës në emër të qytetarëve, duke siguruar që politikat dhe veprimet e qeverisë janë efikase dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve. Mbikëqyrja e ekzekutivit nga Kuvendi bëhet përmes mekanizmave të ndryshëm të përcaktuara në Rregullore. Këto mekanizma përfshijnë pyetjet parlamentare, interpelancat, raportet e zbatimit të ligjeve dhe debatet parlamentare për të diskutuar për politikat qeverisëse. Me anë të këtyre mekanizmave fuqizohet rolin kushtetues i Kuvendit në raport me pushtetin ekzekutiv, e cila garanton rritjen e transparencës dhe e llogaridhënies të qeverisë.

Të dhënat e monitorimit për periudhën raportuese, tregojnë se gjatë këtij sesioni për dallim nga periudha e njëjtë e legjislaturës së VII-të, Kuvendi ka shënuar një ngritje të performancës në ushtrimin e rolit mbikëqyrës me fokus kryesor në mekanizmin e pyetjeve parlamentare. Po ashtu, për dallim nga legjislatura e kaluar, Kuvendi këtë sesion të parë të punës të legjislaturës së VIII-të i ka kushtuar një vëmendje më të madhe institucioneve të pavarura.

### **Pyetjet parlamentare**

Mekanizmin e pyetjeve parlamentare si formë për të ushtruar rolin mbikëqyrës e kanë shfrytëzuar 39 deputetë nga 120 sa janë gjithsej. Për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar, ku ishin parashtruar gjithsej 71 pyetje parlamentare, këtë sesion Kuvendi i Kosovës është shquar për numër më të madh të pyetjeve parlamentare gjegjësisht 108 pyetje parlamentare, drejtuar kabinetit qeveritar, apo 37 pyetje më shumë. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara, 89 prej tyre kanë marrë përgjigje nga kabineti qeveritar ose shprehur në përqindje 82% e tyre.

Prej tyre, 45 pyetje parlamentare janë parashtruar nga grupi parlamentar i PDK-së, pasuar nga LVV me 42 pyetje, AAK me 19 pyetje, LDK me 2 pyetje, ndërsa deputetët nga LS-ja dhe grupi Multietnik nuk kanë parashtruar asnjë pyetje parlamentare. Prej 39 deputetëve që kanë parashtruar pyetje parlamentare, 25 deputetë janë nga LVV, shtatë deputetë nga PDK, gjashtë deputetë nga AAK dhe një deputet nga LDK. Deputetët me më së shumti pyetje parlamentare janë Bekim Haxhiu (24), Time




Fig.3 Numri i pyetjeve me përgjigje sipas grupeve parlamentare

Nga 18 anëtarë të kabinetit qeveritar, deputetët kanë parashtruar pyetje parlamentare ndaj 15 prej tyre. Cak i adresimit të pyetjeve parlamentare kanë qenë ministri i Shëndetësisë Arben Vitia që për shkak edhe të situatës shëndetësore me pandeminë COVID- 19 ka marrë më së shumti pyetje gjithsej 23 të tilla. Pas tij është Kryeministri Kurti (18 pyetje) ministri Hekuran Murati (14 pyetje), ministri Liburn Aliu (11) dhe ministrja Arbërie Nagavci (10). Ndërkaq, ndër ministrat që kanë dhënë më së shumti përgjigje bazuar në numrin e pyetjeve që kanë marrë janë ministrja Arbërie Nagavci me 10 përgjigje nga 10 pyetje, ministri Hekuran Murati me 13 përgjigje nga 14 pyetje, ministri Liburn Aliu me 9 përgjigje nga 11 pyetje, Kryeministri Kurti me 16 përgjigje nga 18 pyetje etj. Kurse ministri Xhelal Sveçla është ministri me më së paku përgjigje në raport me pyetjet që kanë marrë, me vetëm një përgjigje nga gjashtë pyetje të parashtruara nga deputetët.

Kabineti qeveritar	Pyetje	Përgjigje	Nuk është përgjigjur
Albin Kurti	18	16	2
Besnik Bislimi	1	0	1
Donika Gërvalla	1	0	1
Emilija Redžepi	0	0	0
Hekuran Murati	14	13	1

Albulena Haxhiu	6	6	0
Armend Mehaj	4	3	1
Xhelal Sveçla	6	1	5
Arben Vitia	22	17	5
Arbërie Nagavci	10	10	0
Hajrulla Çeku	5	4	1
Elbert Krasniqi	1	1	0
Liburn Aliu	11	9	2
Faton Peci	5	5	0
Rozeta Hajdari	1	1	0
Artane Rizvanolli	3	3	0
Goran Rakić	0	0	0
Fikrim Damka	0	0	0

Tabela.1 Pyetjet parlamentare dhe numri i pyetjeve me përgjigje nga kabineti qeveritar

Në aspektin gjinor, pyetjet parlamentare shpërfaqin një dominim më të madh të deputeteve gra, të cilat prijnë në parashtrimin e pyetjeve parlamentare, ku pothuajse gjysma e tyre apo 18 deputete gra nga 41 sa janë gjithsej kanë parashtruar të paktën një pyetje parlamentare, ndërsa vetëm 21 deputetë burra nga 79 sa janë gjithsej kanë parashtruar pyetje parlamentare. Ndërkaq nëse shohim në përgjithësi numrin e pyetjeve të parashtruara nga deputetët burra dhe deputetët gra ka një dallim dukshëm më të madh, ku deputetët burra kanë parashtruar 60% të pyetjeve parlamentare, ndërkaq deputetët gra i kanë parashtruar 40% të tyre.

### **Interpelancat dhe debatet parlamentare**

Instrumenti i interpelancës është një prej mekanizmave përmes të cilave Kuvendi kontrollon pushtetin ekzekutiv. Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur vetëm dy interpelanca drejtuar ministrit të ministrisë së Financave Hekuran Murati, numër ky i njëjtë i interpelancave të mbajtura gjatë sesionit pranveror të vitit 2020. Të dyja interpelancat e mbajtura janë iniciuara nga grupi parlamentar i AAK-së dhe në të dyja është diskutuar lidhur me çështje që ndërlidhen me pandeminë COVID-19. Dy temat e trajtuara ishin ajo për shtesat e pensionistëve, punëtorëve shëndetësor dhe institucioneve të sigurisë, dhe falja e gjobave për bizneset e prekura nga situata me pandeminë COVID-19. Në të dy rastet, grupi iniciues i interpelancave në fjalë ka propozuar për miratim dy propozim - rezoluta por që nuk kanë marrë përkrahjen e shumicës së deputetëve që kanë votuar.

Në anën tjetër, ngjashëm sikurse në periudhën e njëjtë në vitin e kaluar kur në Kuvend dominonin më shumë debatet parlamentare, me gjithsej gjashtë të tilla, edhe në këtë sesion Kuvendi ka mbajtur gjithsej pesë debate parlamentare. Të gjitha debatet e mbajtura janë iniciuar nga opozita përkatësisht katër nga grupi parlamentar i PDK-së, dhe një tjetër nga grupi parlamentar i LDK-së. Tri nga temat e ngritura për debat nga ana e grupit parlamentar të PDK-së kanë qenë kryesisht në lidhje me pandeminë COVID-19, në tri fusha atë shëndetësore, ekonomike dhe arsimore, dhe ajo për 100-ditëshin e punës së Qeverisë Kurti kurse në debatin e thirrur nga LDK është trajtuar tema e zbatimit të zotimeve të Uashingtonit. Ndonëse për secilin debat është propozuar edhe projekt-rezoluta, asnjë prej tyre nuk ka marrë përkrahjen nga Kuvendi dhe si të tilla janë refuzuar me anë të votës së deputetëve të shumicës.

## **Rezolutat**

Rezolutat si akte ligjërisht jo-obligative përmes të cilave Kuvendi shpreh qëndrimin institucional ndaj çështjeve të caktuara dhe masat që duhet të ndërmerren nga ana e ekzekutivit, jo rrallë herë janë injoruar nga institucionet ekzekutive.

Ashtu sikurse në periudhë e njëjtë të vitit të kaluar, edhe në këtë periudhë janë propozuar shtatë rezoluta nga ana e deputetëve. Për dallim nga periudha e vitit të kaluar kur për mungesë kuorumi në vendimmarrje shumica e rezolutave nuk kishin marrë epilog, gjatë këtij sesioni nuk ka pasur mungesë kuorumi për vendimmarrje meqë të gjitha grupet parlamentare kanë shprehur qëndrimin e tyre për to me anë të votës. Nga shtatë rezolutat e propozuara, vetëm një ka marrë përkrahjen e Kuvendit, gjashtë të tjera janë hedhur poshtë. Rezoluta me anë të secilës Kosova njeh gjenocidin në Srebrenicë e iniciuar nga deputetët boshnjak është miratuar me mbështetje të plotë nga deputetët me përjashtim të atyre të Listës Serbe. Ndërsa gjashtë rezolutat e tjera të propozuara nga opozita (tri prej tyre janë propozuar nga PDK, dy nga AAK dhe një nga LDK) që kanë rrjedhë nga interpelancat dhe debatet parlamentare nuk kanë marrë numrin e mjaftueshëm të votave për tu miratuar. Shumica e këtyre rezolutave lidhen me situatën me pandeminë kurse vetëm një ka të bëjë me procesin e dialogut Kosovë – Serbi.




Fig. 4 Numri i rezolutave të iniciuara dhe statusi i tyre

Rezolutat në raste të rralla kanë gjetur përkrahjen nga të gjitha grupet parlamentare, dhe madje ka pasur mungesë vullneti dhe gatishmërie që të harmonizohen ato mes të gjitha grupeve parlamentare. Në shumicën e rasteve draftimi i rezolutave është kthyer më shumë në shprehjen e vullnetit të një grupacioni politik në Kuvend, përmbajtja e së cilës nuk pranohet nga pjesa tjetër e partive në Kuvend.

### **Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve**

Monitorimi i zbatimit të ligjeve nga Kuvendi është një prej mekanizmave mbikëqyrës që ka më shumti sfida në funksionim. Në të gjitha raportet vlerësues të performancës së Kuvendit qoftë nga organizatat vendore apo ato ndërkombëtare, potencohet fakti që mbikëqyrja parlamentare ndaj ekzekutivit, veçanërisht ndaj zbatimit të ligjit mbetet e dobët. Trendi i performancës jo të mirë të Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve ka vazhduar edhe në këtë legjislaturë gjegjësisht në sesionin e parë të punës.

Bazuar në planet e punës të Komisioneve Parlamentare, vetëm 7 nga 14 komisione kanë përfshirë



aktivitete të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit. Mbështetur në këto plane vjetore të komisioneve përkatëse, për sesionin pranveror të këtij viti janë planifikuar të mbikëqyren gjithsej 11 ligje. Për këtë periudhë kohore, Kuvendi ka miratuar raportin për vetëm një ligj të mbikëqyrrur nga Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti. Nga 11 ligje të planifikuara, sipas planeve respektive shtatë prej tyre janë paraparë të fillojnë dhe të përmbyllen brenda sesionit pranveror dhe për katër të tjera është planifikuar që aktivitetet të fillojnë në sesionin pranveror ndërsa të përmbyllen në sesionin vjeshtor. Vetëm tri komisione u janë përmbajtur planifikimeve të tyre për fillimin e aktiviteteve mbikëqyrëse gjatë të cilave shtatë ligje do t'u nënshtrohen procesit të mbikëqyrjes por që nuk kanë përfunduar ashtu siç është planifikuar në planet respektive të punës. Ndërkaq katër komisione nuk kanë filluar fare aktivitetet mbikëqyrëse për ligjet përkatëse pavarësisht planifikimeve për një gjë të tillë.




Fig. 5 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve gjatë sesionit pranveror 2021

### **Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura**

Për dallim nga legjislaturat e tjera, legjislatura e VIII-të qysh prej fillimit të punës fokusin kryesor e ka pasur në shqyrtimin dhe miratimin e rekomandimeve nga komisionet përkatëse parlamentare për shkarkimin e disa prej bordeve të institucioneve të pavarura. Në këtë drejtim, mes shumicës parlamentare dhe opozitës ka pasur mospajtme të thella për rekomandimet për shkarkim në përgjithësi dhe procedurën e shkarkimit në veçanti. Pavarësisht mospajtimeve, Kuvendi me shumicë

votash ka shkarkuar bordet e katër institucioneve të pavarura siç janë: bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), bordin e Radio Televizionit të Kosovës (RTK), bordin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), dhe bordin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), si dhe një anëtar të bordit të KOSTT-it.

Procedura e ndjekur nga Kuvendi në rastin e shkarkimit të këtyre bordeve nuk ka qenë e njëjtë. Fillimisht, për dy bordet e para të shkarkuara ajo e AKP-së dhe e KPM SHCK-së, Kuvendi ka aplikuar procedurën e shkarkimit të bordit në pako me vetëm një procedurë votimit. Ndërsa, më pastaj Kuvendi ka ndryshuar procedurën e shkarkimit dhe dy bordet e tjera atë të RTK-së dhe të ARH-së, ka aplikuar procedurë të votimit individual për secilën anëtar të bordit përkatës.

Gjatë këtij sesioni parlamentar, Kuvendi ka zgjedhur gjithsej 39 anëtarë të bordeve dhe pesë kryesues të institucioneve të pavarura, ndërsa kanë dështuar të zgjedhin pesë zëvendësit e Avokatit të popullit, një gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe tre anëtarë të KPM-së. Këtë sesion, Kuvendi me shumicë votash ka arritur që të emëroj shtatë anëtarë të KSHC-së të AKK-së, dhjetë anëtarët e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, shtatë anëtarët e KKTK-së, pesë anëtarë të ARKEP-it, tetë anëtarë të AKP-së, dhe dy anëtarë të ZRRE-së. Gjithashtu Kuvendi përveç anëtarëve të bordeve, këtë sesion ka zgjedhur edhe Komisioneren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, drejtorin e Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit, kryesuesin e Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullativ për Shërbimet e Ujit, Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës si dhe kryesuesin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Nga gjithsej 14 komisione, nëntë prej tyre kanë shqyrtuar raportet vjetore të organeve të pavarura për vitin 2020, kurse gjithsej janë shqyrtuar 22 raporte vjetore të këtyre institucioneve. Komisioni për Buxhet dhe Financa përveç shqyrtimit të raporteve vjetore të linjës ka shqyrtuar në aspektin financiar të gjitha raportet tjera të shqyrtuara paraprakisht nga komisionet funksionale. Nga këto raporte, 11 prej tyre me vendim të Komisioneve përkatëse që i kanë shqyrtuar ato, janë proceduar edhe në seancën për shqyrtim dhe miratim të tyre në përputhje me nenin 72 të Rregullores së Punës.

### **Raportimet e ministrave në komisionet parlamentare**

Sa i përket mbikëqyrjes nga komisionet parlamentare, 10 prej 14 komisioneve parlamentare kanë ftuar për raportim anëtarët e kabinetit qeveritar. Për periudhën raportuese, gjithsej 31 herë kanë raportuar ministrat në komisionet përkatëse, që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë tetë raportime më shumë.

Sa i përket Komisioneve që kanë ftuar më së shumti ministra në raportim prinë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me tetë raportime, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me gjashtë raportime, pasuar nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere me pesë raportime, Komisioni për Integrim Evropian me tri raportime. Me nga dy raportime janë Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Komisioni për Arsim, Shkencë, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, kurse me nga një raportim janë Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale Gjatë Luftës, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Ndërkaq katër komisione parlamentare të tjera nuk kanë pasur asnjë raportim të ministrave gjatë këtij sesioni.

## **Performanca e trupave të punës së Kuvendit**

### **Kryesia e Kuvendit**

Kryesia e Kuvendit, si përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit, detyrat e së cilës përfshijnë përgatitjen e Programit Vjetor të Punës së Kuvendit, përgatitjen e rendit të ditës së mbledhjeve të Kuvendit, përgatitjen e kalendarit të punës dhe aspekte të tjera administrative që bien në domenin e saj, gjatë këtij sesioni ka zhvilluar në mënyrë të rregullt takime javore për të caktuar kalendarin e punës për javën përkatëse dhe për të marrë vendime në kuadër të fushëveprimtarisë së saj. Për periudhën raportuese, Kryesia e Kuvendit ka mbajtur gjithsej 18 mbledhje, që për dallim nga periudha e njëjtë e vitit 2020, janë mbajtur dy mbledhje më shumë. Në dy raste, mbledhjet e caktuara kanë dështuar në mungesë të kuorumit për vendimmarrje.

Takimet e rregullta të kësaj trupe kanë kontribuar në organizim dhe menaxhim më të mirë të punëve në Kuvend dhe mbarëvajtjen e punimeve plenare për dallim nga legjislaturat e kaluara kur organizimi i punëve ishte kthyer në problematik që pengonte funksionimin e mirëfilltë të Kuvendit. Me caktimin e seancave në intervale të rregullta kohore dhe agjendës së punimeve me më pak pika për diskutim ka mundur që pjesa dërrmuese e seancave të përmbillen në ditët e caktuara paraprakisht.

Pavarësisht mospajtimeve e përplasjeve mes mazhorancës dhe opozitës në seanca e komisione, në mbledhjet e Kryesisë kryesisht ka mbizotëruar një frymë bashkëpunuese dhe konsensuale mes përfaqësuesve të të gjitha grupeve parlamentare.

Përveç caktimit të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe shqyrtimit të çështjeve të proceduar nga komisionet, Kryesia në mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe ka formuar Delegacionin e Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë; Delegacionin e Kuvendit të Kosovës në Asamblenë e Këshillit të Evropës; Delegacionin e Kuvendit të Kosovës në Komisionin parlamentar për MSA me BE-në si dhe ka mandatuar Forumin për Transparencë Parlamentare të legjislaturës së VIII-të. Po ashtu Kryesia, në përputhje me detyrat e saj, në mbledhjet respektive ka shqyrtuar edhe kërkesat e deputetëve dhe delegacioneve për zhvillimin e aktiviteteve të diplomacisë

parlamentare si dhe ka shqyrtuar dhe miratuar raportet e shpenzimeve të Kuvendit dhe projektbuxhetin për vitin e ardhshëm.

## **Komisionet parlamentare**

Gjatë sesionit pranveror 2021, komisionet parlamentare kanë realizuar gjithsej 176 mbledhje, si dhe janë zhvilluar gjashtë dëgjime publike. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, kur janë mbajtur 145 mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publike, shohim se gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 31 mbledhje dhe pesë dëgjime publike më shumë.




Fig.6 Takimet e komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror 2021

Përgjatë këtij sesioni është vërejtur një disbalancë në dinamikën e punës së komisioneve. Përderisa Rregullorja e Kuvendit obligon komisionet të takohen të paktën dy herë në muaj, kësaj dispozite i janë përmbajtur 11 nga 14 komisionet e Kuvendit. Vlen të theksohet se një pjesë e komisioneve parlamentare kanë përmbushur vetëm normën e përcaktuar në Rregullore, pa kaluar numrin prej dy mbledhjeve për muaj.

Nga numri i përgjithshëm i mbledhjeve të mbajtura, nga komisionet që kanë mbajtur më së shumti mbledhje prinë Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me 22 mbledhje, pasuar

nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere me 19 mbledhje, dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me 18 mbledhje. Kurse komisionet me më së paku mbledhje të zhvilluara gjatë periudhës raportuese janë Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me nga gjashtë mbledhje, dhe Komisioni për Integrim Evropian me tetë mbledhje.

Trendi i numrit të ultë të dëgjimeve publike ka vazhduar edhe këtë sesion parlamentar, ngjashëm sikurse në periudhën e njëjtë të vitit 2020. Për periudhën raportuese, vetëm tri komisione parlamentare kanë mbajtur dëgjime publike. Ajo çfarë vlen të theksohet është që nuk ka pasur dëgjime publike për projektligjet e shqyrtuara gjatë kësaj periudhe.

## **Mbarëvajtja e seancave parlamentare**

Kuvendi i Kosovës në sesionin e parë parlamentar të legjislaturës së VIII-të ka shënuar rritje të lehtë sa i përket numrit të përgjithshëm të seancave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjegjësisht sesionin pranveror të legjislaturës së VII-të. Prej fillimit të kësaj legjislature janë mbajtur 23 seanca duke përfshirë edhe seancën konstituive, prej të cilave 16 ishin seanca të rregullta, katër të jashtëzakonshme dhe dy seanca solemne. Në 13 raste seancat kanë vazhduar për një ditë tjetër ndërkaq tri prej tyre nuk kanë arritur të përmbyllen për shkak të mungesës së kuorumit për t'iu dhënë epilog katër pikave të mbetura nga këto seanca.

Me 16 seanca plenare të mbajtura në periudhën raportuese, kjo paraqet një ngritje në krahasim me sesionin e kaluar, gjatë të cilit sesion Kuvendi kishte mbajtur 13 seanca plenare apo tri më pak. Kurse sa i përket seancave të jashtëzakonshme, këtë sesion Kuvendi ka mbajtur katër seanca të jashtëzakonshme, tri më pak nga sa janë mbajtur sesionin pranveror të vitit 2020. Vetëm dy seanca solemne janë mbajtur në këtë sesion të punës, për dallim nga katër të mbajtura në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.




Fig. 7 Numri i seancave të mbajtura gjatë sesionit pranveror 2021

Në pesë raste të ndryshme gjatë punimeve plenare, opozita kishte lëshuar sallën për shkak të mosmarrëveshjeve me shumicën parlamentare. Bojkotimet e punimeve nga ana e opozitës në dy raste kanë ardhur si shenjë revolte për mospjesëmarrjen e kryeministrit Kurti në diskutimet ku ka qenë i ftuar. Opozita gjithashtu e ka lëshuar sallën edhe në seancën kur është votuar qeveria Kurti, si dhe në seancë e datës 02 gusht kur shumica parlamentare kishte zhvendosur pikën për debat parlamentar të iniciuar nga opozita si pikë të fundit me anë të mocionit procedural. Një veprim të njëjtë, opozita e ka bërë edhe në seancën e datës 06 maj kur kishte pasur mosmarrëveshje mes deputetëve të opozitës dhe kryesueses së seancës për mënyrën e menaxhimit të seancës. Kjo seancë ndër të tjera është karakterizuar edhe me përdorim të gjuhës dhe sjelljeve joparlamentare nga ana e deputetëve dhe ministrave prezent, duke penguar kështu mbarëvajtjen e punimeve dhe ndërprerjen e punimeve për shkak të situatës së krijuar. Megjithatë, diskutimet gjatë punimeve plenare shpeshherë kanë kaluar në debate personale për çështje të cilat nuk ishin paraparë për diskutim siç ishte diskutimi lidhur me punësimet familjare në institucionet shtetërore i seancës së 03 gushtit, i cili përfundoj në akuza personale mes deputetëve për nepotizmin në institucione.

Mungesa e kuorunit në vendimmarrje në punimet plenare është vë në pah kryesisht në votimin e çështjeve që kërkojnë 2/3 e votave të gjithë deputetëve. Mungesa e kuorunit në shumicën e rasteve ka ardhur si rezultat i mospjesëmarrjes së deputetëve në votim pavarësisht prezencës fizike por në disa raste për shkak të mungesave të theksuara të deputetëve në sallë.

### **Pjesëmarrja e deputetëve në seanca**

Një problematikë që po e përcjellë këtë legjislaturë ngjashëm si në ato të kaluarat janë mungesat e shumta të deputetëve në seancë, veprime këto që padyshim që kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punimeve plenare. Sipas të dhënave të siguruara nga Kuvendi, deri në fund të muajit korrik deputetët kanë munguar plot 414 herë. Nëse kalkulohet mesatarja e mungesave të deputetëve për secilën seancë, i bie që mesatarisht kanë munguar deri në 15 deputetë. Mungesa e mekanizmave sanksionues brenda Rregullores së Punës, për këto veprime, u ka dhënë komoditetin deputetëve që të mos vijojnë punimet në mënyrë të rregullt. Përveç mungesave, një fenomen tjetër që shpesh është vënë re është që një pjesë e deputetëve ndonëse kanë marrë pjesë në fillim të seancës nuk kanë qëndruar në seancë gjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur punimet. Sipas të dhënave nga listat e pjesëmarrjes së deputetëve në seanca shihet se në secilin seancë numri i deputetëve të nënshkruar është mbi 80. Ndërkaq në shumë raste, kryesuesi/ja e seancës është detyruar të shtyjë seancën, të kërkojë pushim ose ta ndërpres atë në mungesë të kuorunit prej 61 deputetëve në sallë.

Sipas të dhënave për pjesëmarrjen e deputetëve në seanca shohim që deputetët e opozitës kanë realizuar dukshëm më shumë mungesa në raport me ata të shumicës parlamentare. Grupi parlamentar i PDK-së është grupi me më së shumti mungesa, me gjithsej 121 mungesa, që mesatarisht secili deputetë i këtij grupi parlamentar kanë munguar rreth shtatë herë. Grupi parlamentar i LDK-së është grupi i dytë parlamentar me më së shumti mungesa, gjithsej 96 mungesa (mesatarja rreth gjashtë mungesa për deputetë). LVV ka regjistruar 79 mungesa (mesatarja rreth një mungesë për deputetë), LS ka 62 mungesa (mesatarja rreth gjashtë mungesa për deputetë), pasuar nga AAK me 39 mungesa (mesatarja rreth pesë mungesa për deputetë), dhe grupi Multietnik me 14 mungesa (mesatarja rreth dy mungesa për deputetë)






Fig.8 Numri i mungesave të deputetëve në seanca sipas grupeve parlamentare dhe mesatarja e mungesave për grup parlamentar



Marrë parasysh gjetjet dhe vlerësimin që KDI ka dhënë lidhur me performancën e Kuvendit gjatë këtij sesionin parlamentar, janë propozuar rekomandimet e mëposhtme:

1. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare - Mbështetur në programin legjislativ të Qeverisë, deri në fund të këtij viti do të shqyrtohen edhe 14 marrëveshje të tjera ndërkombëtare. Meqë ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kërkon 2/3 e votave të deputetëve, kjo nënkupton që shumica parlamentare e vetme nuk i ka votat që t'i kalojë ato. Andaj, KDI fton shumicën parlamentare gjegjësisht Qeverinë që të ndërtoj një qasje bashkëpunuese me opozitën, dhe të bëj përpjekje për gjetjen e një gjuhe të përbashkët, në funksion të arritjes së pajtueshmërisë për miratimin e tyre. Marrë parasysh rëndësinë e këtyre marrëveshjeve, KDI konsideron që shumica parlamentare dhe opozita e kanë për obligim që të bashkëpunojnë për çështje që shkojnë përtej interesave partiake dhe kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve.
2. Vendosja e sanksioneve financiare për mungesat e deputetëve në seanca – mungesat e deputetëve në seanca muajt e fundit ka qenë shumë e shprehur, mandej një pjesë e deputetëve ndonëse kanë marrë pjesë në fillim të seancës nuk kanë qëndruar përgjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur punimet plenare. KDI konsideron që kjo çështje duhet të adresohet në Rregulloren e re të punës, ku do të parashiheshin sanksione financiare për deputetët që mungojnë në punime pa arsye objektive dhe atyre që përfitojnë mëditjet pa qëndruar prezent gjatë gjithë kohës sa zgjatin punimet.
3. Përzgjedhja e bordeve të institucioneve të pavarura të shkarkuara nga Kuvendi – Ndër vite ka qenë problematik funksionimin i institucioneve të pavarura për shkak të mungesës së plotë të anëtarëve të bordeve të tyre që e kanë bordin si organin e vetëm me kompetenca ekzekutive. Shkarkimi i plotë i bordeve të këtyre institucioneve nga ana e Kuvendit i ka bërë ato jofunksionale deri në përzgjedhjen e bordeve të reja. Duke ditur rëndësinë e funksionimit të atyre bordeve dhe kohën që merr procedura nga shpallja e konkursit deri në përzgjedhjen e tyre në seancë, KDI konsideron që është e domosdoshme që Kuvendi të vë si detyrë prioritare në sesionin vjeshtor kompletimin e këtyre bordeve. Ky proces duhet të kryhet në procedurë

të hapur, transparente dhe konkurruese ashtu siç e parasheh Kushtetuta dhe ligjet përkatëse në fuqi.

4. Përmbyllja e procesit të rregullores së re të Punës – Kuvendi gjegjësisht Komisioni për Legjislacion ka krijuar grupin punues dhe ka filluar punën në draftimin e Rregullores së re. Siç dihet tashmë ky proces nuk ka arritur të përmbyllet tash e disa legjislatura për shkak të mos arritjes së konsensusit ndërmjet subjekteve politike lidhur me përmbajtjen e rregullores së re. Duke marrë parasysh konsensusin mes grupeve parlamentare që është krijuar deri tani që ky proces të përmbyllet me sukses, KDI vlerëson që është e domosdoshme që i gjithë procesi i shqyrtimit dhe miratimit të këtij dokumenti të përfundoj brenda këtij viti. Avancimi i rregullave të brendshme do t'i ndihmojnë Kuvendit në përmirësimin e performancës dhe përmbushjen e mandatit të tij kushtetues.
5. Përfshirja më e madhe e publikut në procesin ligjvënës - Kuvendi po vazhdon me trendin e numrit të ultë të dëgjimeve publike gjatë procesit ligjvënës sikurse në të kaluarën. Mungesa e konsultimeve publike gjatë këtij procesi cenon standardet parlamentare. Në mënyrë që ligjet e miratuara të gjejnë zbatim në praktikë është më se e nevojshme që Komisionet parlamentare të synojnë përfshirjen dhe konsultim të një numri sa më të madh të akterëve në procesin legjislativ.